REPUBLIKA E SHQIPERISE
SH.A."BUKA" TIRANE
Nr. 112 Prot.

Tirane, me 22.08.2011

REPUBLIKA E SHQIPERISE SHOQERIA ANONIME "BUKA" SHA TIRANE

VENDIM Nr 3

I MBLEDHJES SE ASAMBLESE SE PERGJITHESHME TE AKSIONEREVE TE SH.A."BUKA" TIRANE

Me date **22 Gusht 2011** ora 11.00 ne seline e Shoqerise Anonime "Buka" Tirane, Rruga e Kavajes, u zhvillua **Mbledhja e Asamblese se Pergjitheshme** te Aksionereve e thirrur nga kjo shoqeri.

Mbledhja u drejtua nga Kryetari Asamblese se Aksionereve **Z.Petrit Pecani** .

Me cilesine e zoteruesit te aksioneve shteterore ne Sh.A. " BUKA " Tirane", merrte pjese **Zoti Ilir Qafa me autorizimin Nr 5953/ 1 date 22.08.2011 nga Ministri Nasip Naco (Bashkengjitur).**

Mbledhja u zhvillua ne pranine e Drejtorit te Pergjithshem te Shoqerise **Z.Abdyl Sinani**, te **Keshillit Mbikqyres**, si dhe te aksionereve te shoqerise qe zoteronin mbi **75 %** te kapitalit.

Rendi i dites i mbledhjes se Asamblese se pergjitheshme te aksionereve ishte :

1. **Miratimin e statutit te Ri te Shoqerise " Buka " SH.A. Tirane (Bashkengjitur).**

Per piken Nr 1 te Rendit te Dites miratimin e Statutit te Ri te Shoqerise :

Ne zbatim te dispozitave te nenit 230 te Ligjit Nr 9901 date 14.04.2008 " Per tregetaret dhe Shoqerite Tregetare , nga ana e aksionerit Shtet u pergatit statuti i ri i shoqerise i cili ju dergua gjithe aksionereve .

Bazuar ne shkresen Nr 5953 /2 date 22.08.20 te ministrit Nasip Naco Statuti i Ri eshte miratuar nga aksioneri shtet qe ka 51 % te aksioneve .
Gjithashtu Statuti u miratua dhe nga pjesa tjeter e aksionereve qe ne total perbejne **85. 567 %** te kapitalit .

Ilir Qafa	**Përf. i METE**	51	%
"Eurodrin dp" Sh.a.		24,575	%
Vladimir Metani perf. me prokure			
Theodhoraq Zguri		9.992	%
	Totali	85. 567	%

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

STATUTI I SHOQËRISË "BUKA" SH.A. TIRANË

"Shoqëria Anonime "Buka" sh.a. e ushtron aktivitetin tregtar në përputhje me Ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" si dhe çdo dispozite tjetër në zbatim të këtij ligji."

Neni 1

Shoqëria anonime emërtohet "Shoqëria "Buka" SH.A.
Më poshtë, kur shkruhet "Shoqëria", të lexohet Shoqëria "Buka" SH.A.
Ky emërtim duhet të figurojë në mënyrë të dukshme, të qartë dhe të detyrueshme në të gjitha aktet apo dokumentet e lëshuara nga kjo shoqëri.
Selia zyrtare e Shoqërisë është në qytetin e Tiranës, në adresën Rruga e Kavajës.
Shoqëria, përveç selisë zyrtare në Shqipëri, mund të hapë ose të mbyllë brenda ose jashtë Shqipërisë filiale, agjenci apo zyra.

Neni 2

Shoqëria ka kohëzgjatje të pakufizuar dhe zhvillon aktivitetin në përputhje me legjislacionin shqiptar, si dhe me dispozitat dhe ndryshimet e Aktit të Themelimit e të Statutit të saj..

Shoqëria zhvillon aktivitetin ekonomiko-financiar në bazë të parimeve të ekonomisë së tregut të lirë dhe të programeve ekonomiko-financiare, kreditë bankare, financime e subvencione të ndryshme.

Shoqëria ka objekt të veprimtarisë prodhimin dhe shitjen e bukës të të gjitha llojeve, të majasë së bukës dhe produkte të tjera nga përpunimi i miellrave.

Shoqëria zhvillon aktivitet ndihmës për nevojat e prodhimit dhe për të tretë.

Shoqëria zhvillon aktivitet import-eksporti dhe biznesi për rritjen e të ardhurave, si dhe jep me qira objekte të lira.

Shoqëria bashkëpunon me donatorë e persona juridikë krediti për kryerjen dhe financimin e investimeve në shërbim të përmirësimeve teknologjike dhe strukturës së prodhimeve, hapjen e linjave të reja prodhimi si dhe për zhvillimin e akktiviteteve ndihmëse, dytësore e biznesi.

Shoqëria kryen operacione financiare, tregtare, industriale etj., që lidhen me objektin e veprimtarisë, ose që janë të lidhura me pasuritë e saj.

Shoqëria përgjigjet vetëm nëpërmjet pasurisë së saj.

Detyrimet e krijuara nga përdorimi i vlerave materiale e financiare të të tretëve duke përdorur të ardhurat nga veprimtaria ekonomiko-financiare, fondet e krijuara si dhe me pjesë nga kapitali themelor kur është e domosdoshme.

Shoqëria nuk përgjigjet për detyrimet e aksionerëve dhe anasjelltas, mbi kuotën e kapitalit të dershur prej tyre, sii dhe për detyrimet e ndërmarra nga shteti shqiptar.

Humbjet e Shoqërisë mbulohen deri në kufirin e vlerës së kontributit në kapitalin themelor dhe përballohen nga aksionarët deri në kufirin e vlerës nominale të kontributit të tyre në kapitalin themelor.

Neni 3
KAPITALI THEMELOR

Kapitali themelor i Shoqërisë është 239.000.000 (dyqindetridhjetenentemlion) Lek dhe i ndarë në 239,000 aksione me vlere nominale 1000 leke secili.

51 (pesëdhjetenjë) përqind e kapitalit aksinar zoterohet nga shteti shqiptar me perfaqesues Ministrine e Ekonomise Tregtise dhe Energjetikes.

Neni 4
SHITJA E AKSIONEVE

Shitja e aksioneve dhe dorëheqja e aksionarit nga Shoqëria bëhet e lirë dhe sipas rregullave të Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", si dhe akteve të tjera ligjore e nënligjore në fuqi.

Neni 5
ORGANET DREJTUESE

Organet drejtuese të Shoqërisë janë:

1. Asambleja e Përgjithshme;
2. Këshilli Mbikqyrës;
3. Administratori.

Neni 6
TË DREJTAT DHE DETYRAT E AKSIONARËVE

Aksionarët kanë të drejtë:
- të marrin pjesë vetë ose me anë të përfaqësuesit të tyre ligjor, në administrimin e Shoqërisë në përputhje me Aktin e Themelimit dhe me këtë Statut;
- të përfaqësohen në asamblenë e përgjithshme me të drejtën e votës sipas kushteve të parashikuara në legjislacionin shqiptar, nga Akti i Themelimit dhe ky Statut i ndryshuar;
- të marrin pjesë nga ndarja e fitimit të Shoqërisë, në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në kapitalin themelor;
- të kërkojnë me shkrim dhe të marrin një nxjerrje (ekstrakt) nga Libri i Aksionarëve të Shoqërisë si dhe të verifikojnë nëse janë evidencuar në Librin e Aksionarëve të Shoqërisë;
- të marrin dijeni për librat e Shoqërisë dhe të shqyrtojnë përmbajtjen e tyre;

- të paraqesin në organet drejtuese të Shoqërisë propozime në lidhje me aktivitetin e saj;
- të heqin dorë nga Shoqëria dhe të cedojnë kuotat e aksioneve që posedojnë në kapitalin themelor të saj;

Detyrimet e aksionarëve janë:
- të bëjnë dershjen e kuotës së tyre në kapitalin themelor në bazë të dispozitave ligjore, të Aktit të Themelimit të Shoqërisë dhe të këtij Statuti të ndryshuar;
- t'i japin Shoqërisë ndihmën e nevojshme për zhvillimin e aktivitetit dhe realizimin e objektivave të saj;
- të përballojnë humbjet e Shoqërisë deri në kufirin e vleftës nominale të aksioneve që posedojnë në kapitalin themelor të saj.

Neni 7
ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME

Asambleja e Përgjithshme është organi kryesor vendimor i Shoqërisë. Në të marrin pjesë të gjithë aksionarët me të drejtë vote.

Çdo aksion i zakonshëm i jep zotëruesit të tij të drejta vote në raport proporcional me pjesën e kapitalit që përfaqëson aksioni.

Asambleja është e Zakonshme dhe e Jashtëzakonshme.

Asambleja, si rregull i zhvillon mbledhjet e saj në selinë e Shoqërisë. Ajo drejtohet nga kryetari i saj, që zgjidhet nga aksionarët me shumicën e votave në kapitalin themelor. Krytari i Asamblesë emëron të paktën një sekretar.

Vendimet e Asamblesë së Përgjithshme, në përputhje me legjislacionin shqiptar, janë të detyrueshme për të gjithë aksionarët, përfshirë edhe ata që nuk janë të pranishëm ose që kanë votuar kundër.

Asambleja nuk mund të shqyrtojë cështje që nuk janë në rendin e ditës.

Neni 8
ASAMBLEJA E ZAKONSHME

Asambleja e zakonshme merr çdo vendim, me përjashtim të atyre që sipas ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", Aktit të Themelimit dhe të këtij Statusti të ndryshuar, janë kompetencë e Asamblesë së Jashtëzakonshme.

Asambleja e zakonshme quhet e ligjshme nëse në mbledhje janë të pranishëm ose të përfaqësuar aksionarët që zotërojnë më shumë se 50 (pesedhjetë) përqind të aksioneve, me të drejtë vote.

Asambleja e zakonshme i merr vendimet me shumicën e votave të aksionarëve që marrin pjesë.

Asambleja e zakonshme i merr vendimet vetëm kur votat pro përfaqësojnë më shumë se ½ e vlerës së kapitalit themelor të pranishëm në mbledhje.

Asambleja e zakonshme thirret në mbledhje të paktën një herë në vit. E drejta për thirrjen e mbledhjes së asamblesë, mënyra e njoftimit, përcaktimi i rendit të ditës, dokumentacioni që do të shqyrtohet e do të mbahet në mbledhje, përfaqësimi i aksionarëve dhe e drejta e votës, zbatohen sipas përcaktimit në ligjin "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare".

Asambleja e Zakonshme vendos për:
- direktivat strategjike të aktivitetit ekonomiko-financiar të Shoqërisë si dhe marrjen e kredive bankare;
- miratimin e programit ekonomiko-financiar të një viti financiar;
- miratimin e propozimeve të lindura gjatë vitit financiar për ndryshimin e strukturës bazë të prodhimit, për kryerjen e investimeve dhe marrjen e kredisë afatgjatë;
- miratimin ose jo të llogarive vjetore të Shoqërisë si dhe shpërndarjen e fitimit e të dividentit dhe krijimin e fondeve;
- zgjedhjen, zëvendësimin, pezullimin ose shkarkimin e anëtarëve të këshillit mbikëqyrës dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- cakton shpërblimin vjetor për anëtarët e këshillit mbikëqyrës, me rastin e miratimit të llogarive vjetore, në përputhje me nenin 160 të ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare".

Neni 9
ASAMBLEJA E JASHTËZAKONSHME

Asambleja e jashtëzakonshme merr vendime vetëm në rast se aksionarët e pranishëm ose të përfaqësuar zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të aksioneve me të drejtë vote. Në mungesë të këtij kuorumi, asambleja mblidhet përsëri, por jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

Ajo merr vendim me një shumicë prej 2/3 që u përkasin aksionarëve të pranishëm ose të përfaqësuar.

Asambleja e jashtëzakonshme e aksionarëve vendos për:

- ndryshimet në Statustin dhe në Aktin e Themelimit të Shoqërisë;
- zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit themelor të Shoqërisë;
- pushimin e aktivitetit të Shoqërisë;
- transformimin e Shoqërisë nga Sh.A. në forma të tjera;
- shpërndarjen e fitimeve.

Neni 10
KËSHILLI MBIKËQYRËS

1. Këshilli mbikëqyrës përbëhet nga 3 (tre) anëtarë, ku një është përfaqësues i Ministrisë së Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, një përfaqësues i Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjitikës dhe një përfaqësues i aksionarëve privatë;

2. Kohëzgjatja e funksionit të tyre është 3 (tre) vjet. Anetare e Keshillit Mbikeqyres jane te gjithe te rizgjedhshem. Ata mund te revokohen nga organi qe i ka emeruar vetem per shkaqe te perligjura;

3. Anetaret e Keshillit Mbikeqyres jane persona fizike. Ata nuk mund te jene te punesuar ne shoqeri;

4. Anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës kanë të drejtë të pranojnë ose jo detyrën që u ngarkohet. Ata kanë të drjtë të japin dorëheqjen, që deklarohet me shkrim dhe i paraqitet menjëherë Këshillit Mbikëqyrës ose Asamblesë së Zakonshme.

Nëse një ose disa vende të anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës mbeten bosh për shkak të vdekjes, shkarkimit apo dorëheqjes, zëvendësimi duhet të kryhet jo më vonë se tre muaj.

Anëtari i Këshillit Mbikëqyrës, i emëruar me zëvendësim të një anëtari tjetër, përfundon mandatin e paraardhësit;

5. Anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës të moshës mbi 65 vjeç nuk mund të jenë më shumë se një e treta e numrit të përgjithshëm në mbyllje të ushtrimit të çdo viti financiar. Nëse kjo përqindje tejkalohet, anëtari më i moshuar do të konsiderohet i shkarkuar zyrtarisht.

Neni 11
KRYETARI DHE ZËVENDËSKRYETARI I KËSHILLIT MBIKËQYRËS

Këshilli Mbikëqyrës zgjedh ndërmjet anëtarëve të tij një kryetar dhe një zëvendëskryetar të cilët ngarkohen të mbledhin këshillin dhe të drejtojnë diskutimet. Ata emërohen për të gjithë kohën e mandatit të tyre në Këshillin Mbikëqyrës dhe janë të rizgjedhshëm.

Këshilli Mbikëqyrës mund të emërojë një sekretar jashtë anëtarëve të tij.

Neni 12
VENDIMET E KËSHILLIT MBIKËQYRËS

1. Këshilli Mbikëqyrës mblidhet sa herë që e kërkon interesi i Shoqërisë, me thirrjen e kryetarit, ose në mungesë të tij, të zëvendëskryetarit.

Kryetari duhet të thërrasë Këshillin Mbikëqyrës brenda 15 ditëve, kur Administratori ose një e treta e anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës i paraqesin atij një kërkesë të motivuar për këtë qëllim.

Nëse kërkesa mbetet pa përgjigje, atëherë autorët e saj mund të therrasin këshillin duke i përmendur rendin e ditës.

Në parim thirrja duhet të bëhet tre ditë përpara, me letër, telegram, telefaks, e-mail. Por ajo mund të bëhet me gojë dhe pa afat në qoftë se anëtarët e këshillit e pranojnë atë.

Çdo thirrje duhet të tregojë çështjet kryesore të rendit të ditës.

Mbledhja e Këshillit Mbikëqyrës bëhet në selinë e shoqërisë ose në çdo vend tjetër të treguar në thirrje.

2. Këshilli mbikëqyrës mund të marrë një vendim të vlefshëm, në qoftë se janë të pranishëm jo më pak se gjysma e anëtarëve të këshillit.

Vendimet merren me shumicë të thjeshtë votash të anëtarëve të pranishëm. Në rast votash të barabarta, ajo e kryetarit është përcaktuese.

3. Këshilli mbikëqyrës mban një regjistër për pjesmarrjen në mbledhje të tij, i cili nënshkruhet nga anëtarët e pranishëm në mbledhje.

4. Vendimet e këshillit mbikëqyrës evidencohen me procesverbale të hartuara në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi, nga kryetari i seancës dhe nga një anëtar i këshillit ose, në mungesë të kryetarit, nga jo më pak se dy anëtarë të këshillit.

Kopje të këtyre procesverbaleve vërtetohen nga kryetari i këshillit mbikëqyrës, zëvendëskryetari dhe nga Administratori.

Neni 13
KOMPETENCAT E KËSHILLIT MBIKËQYRËS

Këshilli mbikëqyrës mbikëqyr dhe analizon punën dhe rezultatet e realizimit të direktivave strategjikë të aktivitetit ekonomiko-financiar të Shoqërisë, programin ekonomiko-financiar të vitit financiar, si dhe detyrat e tjera themelore të vëna nga Asambleja.

Këshilli mbikëqyrës, vetë ose mbi bazën e propozimeve të administratorit, i paraqet asamblesë së jashtëzakonshme propozime për pushimin e aktivitetit të shoqërisë ose transformimin e saj në forma të tjera.

Këshilli mbikëqyrës drejton dhe merr pjesë në negociimin me institucionet donatore e financuese si dhe vendos për bashkëpunimin dhe përfitimin e ndihmave e kredive afatgjata sipas kushteve që i gjykon të pranueshme.

Këshilli mbikëqyrës i propozon Asamblese se Pergjithshme hapjen, bashkimin si dhe mbylljen e përkohshme të veprimtarive. Ai propozon gjithashtu për blerjen, shkëmbimin dhe shitjen e pasurive që përbëjnë aktivin e qëndrueshëm të shoqërisë.

Këshilli mbikëqyrës ushtron kontroll për administrimin e Shoqërisë nga Administratori i saj dhe i jep këtij të fundit autorizim paraprak për kryerjen e operacioneve të kompetencës së Këshillit Mbikëqyrës.

Këshilli mbikëqyrës mund ti ngarkojë anëtarëve mandat të posaçëm për një ose disa cështje të caktuara.

Këshilli mbikëqyrës vendos për përbërjen e drejtorisë së Shoqërisë, emëron, pezullon, shkarkon dhe zëvendëson anëtarët e saj, si dhe cakton aktin e emërimit, mënyrën dhe masën e shpërblimit të tyre.

Miraton propozimet e Administratorit për strukturën dhe numrin e punonjësve të administratës si dhe pagat e organikës, ndërsa me rastin e formimit të Shoqërisë, miraton numrin e punëtorëve dhe më pas edhe shtimin ose paksimin masiv të tij.

Thërret në raport drejtorinë të paktën një herë në tre muaj, duke përfshirë këtu edhe raportimin për rezultatet ekonomiko-financiare vjetore, me qëllim verifikimi e kontrolli si dhe për të patur të dhëna të plota për të paraqitur në mbledhjen vjetore të asamblesë vërejtje mbi raportin e drejtorisë dhe mbi llogaritë e vitit që analizon mbledhja.

Këshilli mbikëqyrës, kur e gjykon të nevojshme, thërret mbledhjen e asamblesë së përgjithshme.

Këshilli mbikëqyrës përcakton kushtet e punës.

Këshilli mbikëqyrës përcakton çështjet që për Shoqërinë përbëjnë sekret.

Anëtarët e këshillit mbikëqyrës dhe sekretaria e tij duhet të ruajnë sekretin në lidhje me informacionin konfidencial apo sekret të Shoqërisë edhe kur nuk janë më në këto detyra.

Neni 14
SHPËRBLIMI I ANËTARËVE TË KËSHILLIT MBIKËQYRËS

Anëtarëve të këshillit mbikëqyrës u jepet shpërblim mujor; për kryetarin e këshillit mbikëqyrës në masën 30 përqind të pagës së Administratorit dhe për anëtarët në masën 20 përqind të pagës së Administratorit.

Këshilli mbikëqyrës cakton për anëtarët e tij shpërblime të jashtëzakonshme sipas rregullave të parashikuara në ligjin "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare".

Neni 15
ADMINISTRATORI

Administratori emërohet nga Këshilli Mbikëqyrës kur për të janë dakort jo më pak se 2/3 e këtij këshilli.
Ai mund të zgjidhet qoftë ndërmjet personave të shoqërisë, qoftë edhe jashtë të punësuarve të saj.

Nëse një anëtar i këshillit mbikëqyrës emërohet Administrator, mandati i tij në këshill merr fund me hyrjen e tij në funksion.

Një person nuk mund të emërohet Administrator në më shumë se një shoqëri.

Administratori mund të shkarkohet nga Këshilli Mbikqyrës vetëm për shkaqe të përligjura. Në rastin kur i interesuari ka lidhur një kontratë punësimi me Shoqërinë, shkarkimi i tij nga funksioni i Administratorit nuk është shkak për zgjidhjen e kësaj kontrate.

2. Administratori emërohet për një periudhë prej 3 (tre) vjetësh. Në rastet e pushimeve dhe të mungesave të tjera të zgjatura, këshilli mbikëqyrës kryen menjëherë zëvendësimin e tij.

Administratori është i riemërueshëm.

Mënyra dhe masa e shpërblimit të Administratorit caktohet nga këshilli mbikëqyrës në aktin e emërimit të tij.

Neni 16
KOMPETENCAT E ADMINISTRATORIT

Administratori përfaqëson Shoqërinë në marrëdhënie me të tretët si dhe ka kompetenca të plota për të vepruar në emër të saj, përveç kompetencave të asamblesë dhe të këshillit mbikëqyrës të Shoqërisë, të përcaktuara në ligje, në Aktin e Themelimit dhe në këtë Statut, si dhe në ndryshimet e bëra atyre. Administratori autorizon anëtarët e tjerë të drejtorisë për ta përfaqësuar, por brenda kuadrit të kompetencave të tij si dhe kompetencave të këshillit mbikëqyrës që i janë lejuar nga ky këshill sipas autorizimit përkatës.

Në marrëdhënie me të tretët Shoqëria merr përsipër detyrimet që rrjedhin nga veprimet e Adminitratorit dhe kur këto veprime nuk përfshihen në objektin e Shoqërisë, përveç rasteve kur Shoqëria provon se të tretët e dinin që veprimi i tij kapërcente objektin e Shoqërisë dhe vepronte me keqbesim, ose kur të tretët nuk mund ta injoronin këtë

veprim, duke patur parasysh faktin se vetë shpallja e Statutit dhe e ndryshimeve të tij nuk janë prova të mjaftueshme.

Kufizimet e kompetencave të Administratorit të caktuara në statustin e ndryshuar duhet të respektohen nga të tretët.

Administratori punon për zbatimin e direktivave strategjike të aktivitetit ekonomiko-financiar, programin ekonomiko-financiar të vitit dhe detyrat e tjera themelore të vëna nga asambleja.

Administratori përgatit projekt-programin ekonomiko-financiar të vitit pasardhës, si dhe bën propozime në kuadrin e direktivave strategjike të Shoqërisë.

Administratori merr masa për zbatimin e parimeve e rregullave kryesore për mbajtjen e kontabilitetit dhe planin e përgjithshëm kontabël, për krijimin e fondeve sipas legjislacionit dhe programeve, si dhe për publikimin e informacionit financiar që mbështetet në të dhënat e kontabilitetit.

Administratori, me iniciativë ose me kërkesë të këshillit mbikëqyrës, i raporton periodikisht atij për rezultatet ekonomiko-financiare të aktivitetit. Ai i raporton mbledhjes vjetore të asamblesë për llogaritë vjetore dhe ndarjen e fitimit, dhe brenda muajit shkurt të vitit pasardhës, u vë në dispozicion këshillit mbikëqyrës dhe ekspertëve llogaritë vjetore dhe raportin e administrimit.

Administratori cakton pagat sipas vendeve të punës, me përjashtim të administratës, bën lëvizjen e punëtorëve nga një vend pune në tjetrin, si dhe shkurtime apo shtesa të vogla të fuqisë punëtore. Ai merr masa administrative ndaj punonjësve të Shoqërisë për shkelje të disiplinës në punë, konform dispozitave ligjore; anëtarët e drejtorisë i propozon këshillit mbikëqyrës.

Administratori i propozon këshillit mbikëqyrës strukturën dhe numrin e punonjësve të administratës si dhe pagat e tyre, si dhe numrin e punëtorëve, shtimin ose pakësimin e tyre masiv.

Administratori merr masa për zbatimin e detyrimeve që i lindin Shoqërisë nga legjislacioni për marrëdhëniet e punës dhe nënshkruan kontrata për llogari të Shoqërisë nën cilësinë e Punëdhënësit.

Anëtarët e drejtorisë dhe gjithë administrata, gjatë punës ose dhe kur nuk janë më këtë detyrë, ruajnë sekretin në lidhje me informacionin konfidencial apo sekret të Shoqërisë.

Administratori, kur e gjykon të nevojshme, thërret mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme.

Aktet me të cilat Shoqëria merr përsipër detyrimet ndaj të tretëve, duhet të mbajnë nënshkrimin e Administratorit ose të personave që autorizon.

Marrëdhëniet zyrtare ndërmjet Administratorit dhe Këshillit Mbikëqyrës duhet të dokumentohen.

Marrëdhëniet brenda Shoqërisë përcaktohen me rregullore të veçantë, miratuar nga Këshilli Mbikëqyrës.

Neni 21

Llogaritë vjetore (bilanci financiar dhe anekset e tij) dhe raportin e administrimit, administratori ia vë në dispozicion ekspertëve kontabël të autorizuar brenda muajit shkurt të vitit pasardhës, ndërsa këta të fundit "Raportin e auditëve të pavaruar dhe pasqyrat financiare" ja paraqesin Këshillit Mbikqyrës brenda një muaji nga marrja në dorëzim e materialeve nga Administratorët.

Neni 22
REZULTATI I USHTRIMIT DHE SHPËRNDARJA E FITIMIT

Rezultati i ushtrimit (fitimi ose humbja) përcaktohet sipas rregullave të planit të përgjithshëm kontabël dhe akteve ligjore e nënligjore përkatëse.

Fitimi që do të shpërndahet, përbëhet nga fitimi i vitit financiar, pasi t'i jenë zbritur sipas ligjit, shumat e lëna për fonde rezervë dhe fonde të tjera të posaçme, si dhe t'i jenë zbritur ose shtuar respektivisht humbjet apo fitimiet e mbartura nga vitet e mëparshme.

Asambleja e zakonshme merr vendim të veçantë për masën e përqindjes nga fitimi neto që do të shpërndahet si divident, pasi të jenë kryer veprimet sipas paragrafit të parë të këtij neni. Dividenti u shpërndahet aksionarëve në raport me përqindjen e posedimit të aksioneve të tyre në kapitalin themelor.

Përbërja, shuma dhe burimet e krijimit si dhe administrimi e përdorimi i këtyre fondeve përcaktohen nga këshilli mbikëqyrës nëpërmjet miratimit nga Asambleja e Përgjithshme, në përputhje me Aktin e Themelimit, këtë statut dhe ligjin "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare".

Fondi rezervë, që është një "rezervë e domosdoshme", krijohet në masën jo më të vogël se 1/20 e fitimit të rezervuar gjatë vitit financiar, pasi t'i jenë zbritur humbjet e viteve të mëparshëm. Kjo lënie mënjanë nuk është e detyrueshme kur "rezerva e domosdoshme" arrin 1/10 e kapitalin themelor.

Asambleja mund të marrë vendim që të shpërndahen shumat e lëna mënjanë për rezervën që ka në dispozicion. Vendimi tregon llojet e rezervës së përdorur.

Përveç rastit të zvogëlimit të kapitalit, asnjë shpërndarje nuk mund t'u bëhet aksionarëve, në qoftë se kapitalet e veta janë ose do të bëheshin mbas kësaj shpërndarjeje, më të vegjël se shuma e kapitalit, të cilit i shtohen rezervat që ligji ose Statuti nuk i lejon të shpërndahen.

Në qoftë se rezultati i ushtrimit është humbje, kjo mbartet për t'u përfshirë në fitimet e ushtrimeve të ardhshme, deri në shuarjen e saj.

Ky Statut i ndryshuar hyn në fuqi menjëherë pas miratimit të tij në Asamblenë e Jashtëzakonshme të Aksionerëve .

REPUBLIKA E SHQIPERISE
SH.A."BUKA" TIRANE
Nr. 112 Prot.

Tirane, me 22.08.2011

VENDIM Nr 3

I MBLEDHJES SE ASAMBLESE SE PERGJITHESHME TE AKSIONEREVE TE SH.A."BUKA" TIRANE

Me date **22 Gusht 2011** ora 11.00 ne seline e Shoqerise Anonime "Buka" Tirane, Rruga e Kavajes, u zhvillua **Mbledhja e Asamblese se Pergjitheshme** te Aksionereve e thirrur nga kjo shoqeri.

Mbledhja u drejtua nga Kryetari Asamblese se Aksionereve **Z.Petrit Pecani** .

Me cilesine e zoteruesit te aksioneve shteterore ne Sh.A. " BUKA " Tirane", merrte pjese **Zoti Ilir Qafa me autorizimin Nr 5953/ 1 date 22.08.2011 nga Ministri Nasip Naco (Bashkengjitur).**

Mbledhja u zhvillua ne pranine e Drejtorit te Pergjithshem te Shoqerise **Z.Abdyl Sinani**, te **Keshillit Mbikqyres**, si dhe te aksionereve te shoqerise qe zoteronin mbi **75 %** te kapitalit.

Rendi i dites i mbledhjes se Asamblese se pergjitheshme te aksionereve ishte :

1. **Miratimin e statutit te Ri te Shoqerise " Buka " SH.A. Tirane (Bashkengjitur).**

Per piken Nr 1 te Rendit te Dites miratimin e Statutit te Ri te Shoqerise :

Ne zbatim te dispozitave te nenit 230 te Ligjit Nr 9901 date 14.04.2008 " Per tregetaret dhe Shoqerite Tregetare , nga ana e aksionerit Shtet u pergatit statuti i ri i shoqerise i cili ju dergua gjithe aksionereve .

Bazuar ne shkresen Nr 5953 /2 date 22.08.20 te ministrit Nasip Naco Statuti i Ri eshte miratuar nga aksioneri shtet qe ka 51 % te aksioneve .
Gjithashtu Statuti u miratua dhe nga pjesa tjeter e aksioneve qe ne total perbejne **85. 567 %** te kapitalit .

Ilir Qafa Përf. i METE	51 %	
"Eurodrin dp" Sh.a.	24,575 %	
Vladimir Metani perf. me prokure Theodhoraq Zguri	9.992 %	
	Totali 85. 567 %	

Procesverbali i Mbledhjes se Asamblese se Pergjithshme te Aksionareve te

Shoqerise BUKA sh.a.

Tirane, me date 16 Shtator 2015, ora 11:00 ne Seline e Shoqerise BUKA sh.a.

Sot me date 16 Shtator 2015 u mbajt Asambleja e Pergjithshme te Aksionareve te Shoqerise BUKA sh.a. ("Shoqeria").

Mbledhja filloi ne ora 11.00 ne perputhje me Njoftimin e bere nga Shoqeria.

Noterja Mimoza Sadushi ne hyrje te mbiedhjes kreu identifikimin e pjesemarresve ne Mbledhje.

Nga Aksionaret e Shoqerise ishin prezent: Z. Lirim Fezollari, mbajtes dhe zoterues i 245,818 Aksioneve me te drejte vote, qe perfaqesojne 86,83% te kapitalit te Shoqerise. Noterja Znj. Mimza Sadushi beri identifikimin e aksionarit prezent ne Mbledhje, duke konstatuar se (i) thirrja dhe mbledhja jane bere konform Ligjit 9901 Per Tregetaret dhe Shoqerite Tregetare ("Ligji Tregetar"); (ii) kuorumi i kerkuar nga Ligji Tregetar per mbajtjen e Mbledhjes dhe marrjen e vendimeve te vlefshme eshte arritur persa kohe ne mbledhje marrin pjese aksionaret qe perfaqesojne te pakten 86,83% te kapitalit te Shoqerise.

Noterja znj. Mimoza Sadushi verifikoi leternjoftimet e personave pjesemarres ne mbledhje:

Z. Hysen Caka – Drejtor i Shoqerise;
Znj. Aurora Dedndreaj – punonjese e Shoqerise;

Z. Lirim Fezollari – ne cilesine e Aksionarit pjesemarres ne Mbledhje

Mbledhja zgjodhi Kryetar te saj Z. Hysen Caka dhe sekretare te mbledhjes Znj. Aurora Dedndreaj.

Kryetari pas verifikimit te bere nga Noterja Znj Mimoza Sadushaj deklaroi mbedhjen te hapur dhe kerkoi te diskutohej ne lidhje me rendin e dites.

1. Miratimi i Statutit te Ri te Shoqerise

Nje kopje e Statutit te Ri te Shoqerise eshte publikuar dhe eshte propozuar per miratim. Kerkesa u hodh ne votim. Aksionari qe perfaqeson 86,83% te aksioneve te Shoqerise, Z. Lirim Fezollari votoi PRO. Statuti i Ri bashkelidhur procesverbalit, MIRATOHET!

2. Largimi i te gjithe Anetareve aktuale te Keshillit Mbikqyres te Shoqerise.

Aksionari qe perfaqeson 86,83% te aksioneve te Shoqerise, Z. Lirim Fezollari votoi PRO. Pika e Rendit te Dites per largimin e te gjithe Anetareve aktuale te Keshillit Mbikqyres te Shoqerise MIRATOHET!

3. Propozimi, zgjedhja i anetareve te Rinj te Keshillit te Administrimit te Shoqerise.

Aksionari qe perfaqeson 86,83% te aksioneve te Shoqerise, Z. Lirim Fezollari propozoi si me poshte vijon per anetare te Rinj te Keshillit te Administrimit te Shoqerise, ne perputhje me Statutin e Ri te Shoqerise:

Kryetar i Keshillit te Administrimit: **Znj. Brunilda Keco**, lindur me 11.06.1982, me karte Identiteti nr. 029715289;

Anetar i Keshillit te Administrimit: **Znj. Laureta Myrtaj**, lindur me 10.03.1981, me nr karte identiteti 029853733;

Anetar i Keshillit te Administrimit: **Z. Gezim Besholli**, lindur me 02.08.1973, me nr karte identiteti 024500821.

Afati ne detyre i Anetarev te Keshillit te Administrimit eshte 3 Vjecar, nga dita e Mbledhjes dhe e marrjes se ketij Vendimi. Paga e Kryetarit te keshillit te Administrimit do te jete vlera e barabarte me 30% te pages mujore te Administratorit te Shoqerise. Paga e anetareve do te jete vlera e barabarte me 15% te pages mujore te Administratorit te Shoqerise.

Z. Lirim Fezollari, votoi PRO. Kandidaturat dhe propozimet e mesiperme dhe pagesat perkatese, MIRATOHEN!

4. Shkarimi i Eksperteve Kontabel te Shoqerise ZNj. Margarita Kalemasi dhe Znj. Violeta Aloci dhe Propozimi dhe zgjedhja e Ekspertes Kontabel te Autorizuar

Kryetari kerkoi propozimin e Aksionareve. Z. Lirim Fezollari votoi pro shkarkimit te Eksperteve Kontabel te Shoqerise ZNj. Margarita Kalemasi dhe Znj. Violeta Aloci.
Z. Lirim Fezollari propozoi Znj. Enkeleda Stefani me nr NIPT K72228006I dhe nr License 208, duke votuar PRO dhe duke MIRATUAR si Eksperte Kontabel te Shoqerise per nje afat 1 Vjecar, nga dita e mbledhjes **Znj. Enkeleda Stefani**.

5. Miratimi i Rregullave Proceduriale te Mbledhjeve te Asamblese se Pergjithshme te Aksionareve

Kryetari shpjegoi qe kjo rregullore behet konform Statutit dhe Ligjit Tregetar, per te mundesuar mbajtjen ne menyre te rregullt dhe konform kerkesave te mire-qeverisjes se koorporatave te Mbledhjeve te Asamblese se Pergjithshme te Aksionareve per Shoqerine. Kjo Rregullore eshte poublikuar me konsultim se bashku me thirrjen e asamblese.

U hodh ne votim kjo pike e Rendit te Dites. Aksionari qe perfaqeson 86,83% te aksioneve te Shoqerise, Z. Lirim Fezollari votoi PRO duke e MIRATUAR tekstin bashkelidhur Procesverbalit.

Kryetari i Mbledhjes pasi u lexoi VENDIMET e mesiperme, u kerkoi Aksionareve pjesemarres, nese kishin dicka per te shtuar.

Nuk kishte asnje verejtje nga Aksionaret pjesemarres ne mbledhje.

Me kerkese te Kryetarit te Mbledhjes, autorizohet Z. Redin Popa, lindur me 23.01.1972, me karte identiteti nr. 028899819 te kryeje regjistrimet perkatese te Vendimeve dhe dokumentave bashkelidhur te miratuara me kete Mbledhje te Asamblese se Pergjithshme te Aksionareve, prane Qendres Kombnetare te Regjistrimit dhe Qendres se Regjistrimit te Aksioneve ne perputhje me Ligjin.

Dokumentat e miratuara i bashkelidhen ketij Prodcesverbali dhe Vendimeve qe do firmosen nga Aksionaret pjesemarres, konform ketij procesverbali.

Asnje vendim tjeter nuk u mor ne kete Mbledhje e cila u mbyll ne ora 11:50 ne Tirane, sot me date 16 Shtator 2015.

KRYETARI I MBLEDHJES

Hysen Caka

SEKRETARJA E MBLEDHJES

Aurora Dedndreaj

STATUTI I SHOQËRISË
BUKA SH.A.
(Sistemi me një Nivel)

TITULLI I
EMRI I SHOQËRISË – SELIA E REGJISTRUAR – KOHËZGJATJA

Neni 1 – Emri i Shoqërisë

1.1 Shoqëria e emërtuar **BUKA Sh.a.** (në vijim referuar si "**Shoqëria**") është një shoqëri aksionare e organizuar sipas ligjeve të Republikës së Shqipërisë, dhe në përputhje me dispozitat e Ligjit no. 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregëtarët dhe Shoqëritë Tregëtare", i ndryshuar ("referuar këtu e më poshtë si "**Ligji Tregtar**").

1.2 Shoqëria ka vulën zyrtare dhe logon e saj.

Neni 2 – Selia Ligjore

2.1 Selia e regjistruar e Shoqërisë është në adresën: BUKA sh.a., Rr. Kavajes, Tiranë, Shqipëri.

2.2 Shoqëria mund të hapë apo të mbyllë filiale, degë dhe/ose zyra përfaqësimi në Shqipëri dhe/ose jashtë saj.

2.3 Në lidhje me marrëdhëniet ndërmjet Shoqërisë dhe aksionarëve, adresa për shkak të detyrës të çdo aksionari, do të jetë adresa që përcaktohet në regjistrin e aksionarëve të Shoqërisë. Në rast ndryshimi të kësaj adrese, aksionari përkatës do të njoftojë menjëherë me shkrim Shoqërinë dhe ndryshimi do të pasqyrohet në regjistrin e aksionarëve të Shoqërisë.

Neni 3 – Kohëzgjatja

3.1 Shoqëria është krijuar për një afat të pacaktuar.

TITULLI II
OBJEKTI

Neni 4 - Objekti

4.1 Objekti i Shoqërisë, do të përfshijë, por, nuk kufizohet në aktivitetet e mëposhtme:

Shfrytëzimi i aseteve dhe pasurive të paluajtshme të Shoqërisë; dhënia e tyre me qera në palë të treta; përdorimi për nevoja të veta të depove, magazinave, ndërtesave; apo dhënia me qera e tyre palëve të treta;

Magazinimi i produkteve të ndryshme në ndërtesat dhe asetet e Shoqërisë për nevojat e veta; apo me qera në favor të palëve të treta;
Tregëtia me shumicë dhe/ose e pakicë e të gjitha mallrave të të gjitha llojeve;
Aktivitet Import dhe/ose Eksport të mallrave dhe të mirave materiale të të gjitha llojeve;
Aktivitet ndërtimi dhe konstruksioni i godinave rezidenciale, qendrave tregëtare, dhe strukturave të ndryshme;
Aktiviteti i manaxhimit, shitjes, dhënies me qera, administrimit për nevoja të Shoqërisë apo në favor të të tretëve të pasurive të paluajtshme, apo tyre të luajtshme;
Aktiviteti i konsulencës në fushën e pasurive të paluajtshme;
Konsulencë dhe aktivitet tregëtar në fushën e arkitekturës, inxhinierisë së ndërtimit;
Aktivitete bar-restorant-klub-klub nate; etj dhe tregëtimi i të gjitha produkteve ushqimore, gatimeve, pijeve të të gjitha llojeve, pa u kufizuar ne pije alkoolike, etj.
Prodhimi i produkteve ushqimore dhe pijeve pa kufizim; tregetimi, manaxhimi dhe administrimi i kësaj industrie;
Organizimi, manaxhimi dhe administrtimi i industrive zbavitëse të të gjitha llojeve dhe për të gjitha moshat dhe shtresat, pa kufizime;
Organizimi i të gjitha aktiviteteve kreative dhe zbavitëse për të gjitha moshat dhe shtresat; organizimi, manaxhimi dhe administrimi i aktiviteteve artistike dhe kulturore;
Prodhimin, shitjen me shumice apo pakice të bukës, të të gjitha llojeve, të majasë së bukës, dhe produkteve të tjera të ngjashme nga përpunimi i miellit;
Të gjitha dhe çdo aktivitet tjetër tregtar, në përputhje me ligjet e Republikës së Shqipërisë.

4.2 Me qëllim përmbushjen e objektit të lartpërmendur, Shoqëria gjithashtu, mund të:

(a) kryejë çdo aktivitet me pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme si edhe aktivitete tregtare, financiare, qera apo hipotekore të cilat mund të konsiderohen të dobishme apo të nevojshme për përmbushjen e objektit të Shoqërisë;
(b) blejë, në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë, interesa në shoqëri të tjera që kanë objekt të ngjashëm me atë të Shoqërisë, në Shqipëri apo jashtë saj; të marrë kredi/hua nga institucione financiare të licensuara në Shqipoëri apo jashtë saj; dhe
(c) të kryejë çdo aktivitet tjetër që mund të konsiderohet i dobishëm apo i nevojshëm për përmbushjen e objektit të Shoqërisë.

4.3 Gjithashtu, Shoqëria mund të kryejë cdo aktivitet tjetër i cili nuk ndalohet nga ligji i zbatueshëm.

TITULLI III
KAPITALI AKSIONAR – AKSIONET – TRANSFERIMI

Neni 5 – Kapitali aksionar

5.1 Kapitali aksionar i nënshkruar i Shoqërisë është 239,000,000.00 (dyqind e tridhjetë e nëntë milionë) Lekë, i ndarë në 283,104.00 (dyqind e tetëdhjetë e tre mijë e njëqind e katër) aksione të zakonshme me vlerë nominale 844.21 (tetë mijë e katërqind e dyzet e katër pike njëzet e një) Lekë secili.

5.2 Asambleja e Përgjithshme përbëhet nga Aksionarët që zotërojnë aksionet e kapitalit të Shoqërisë. Asambleja e Përgjithshme mund të vendosë zmadhimin e kapitalit aksionar me anë të emetimit të aksioneve të reja, zmadhimit të kufizuar të kapitalit aksionar, zmadhimit të autorizuar të kapitalit aksionar, kalimit në kapitalin bazë të rezervave të disponueshme dhe të fitimeve të pashpërndara, emetimit të obligacioneve të konvertueshme dhe rritjes së vlerës nominale të aksioneve ekzistuese.

5.3 Asambleja e Përgjithshme mund të zvogëlojë kapitalin aksionar të Shoqërisë nëpërmjet zvogëlimit të vlerës nominale të aksioneve, zvogëlimit të thjeshtëzuar të kapitalit aksionar, apo anullimit të aksioneve por në asnjë rast kapitali aksionar nuk mund të jetë më i vogël se kapitali i regjistruar i shoqërisë.

Neni 6 – Aksionet

6.1 Aksionet janë të zakonshme.

6.2 Akti i emetimit të aksioneve hartohet në çastin e emetimit fillestar të aksioneve dhe ky akt përmban të dhënat dhe duhet të jetë në përputhje me procedurat e përcaktuara në ligjin e zbatueshëm.

6.3 Çdo aksion jep të drejtën e një vote.

6.4 Administratori i Shoqërië harton dhe mban regjistrin e aksionarëve të Shoqërisë në selinë e regjistruar të Shoqërisë i cili duhet të përmbajë: emrin dhe mbiemrin apo emrin e shoqërisë, numrin e aksioneve, vlerën nominale të aksionit, adresën për shkak të detyrës apo adresën zyrtare të aksionarit.

Neni 7 – Transferimi i Aksioneve

7.1 Aksionet e Shoqërisë mund të transferohen lirisht tek palë të treta, tërësisht apo pjesërisht, nga secili prej aksionarëve të Shoqërisë, pa qenë i nevojshëm njoftimi, apo mbledhja e aksionarëve.

7.2 Çdo transferim i së drejtës së pronësisë lidhur me aksionet e Shoqërisë si edhe krijimi apo transferimi i çdo të drejte tjetër lidhur me këto do të regjistrohet në regjistrin e aksionarëve. Transferuesi do të njoftojë me shkrim Administratorin e Shoqërisë në lidhje me transferimin në ditën efektive të këtij transferimi

TITULLI IV
SEKSIONI I
ORGANET E SHOQËRISË

Neni 8 – Organet e Shoqërisë

Organet e Shoqërisë janë:

1) Asambleja e Përgjithshme;
2) Këshilli i Administrimit;
3) Administratori/ët; dhe
4) Ekperti/ët Kontabël i Autorizuar.

SEKSIONI II
ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME

Neni 9 – Asambleja e Përgjithshme

9.1 Organi vendimmarrës i shoqërisë është Asambleja e Përgjithshme e cila përbëhet nga Aksionarët e Shoqërisë.

9.2 Çdo aksionar ka të drejtë të marrë pjesë në Asamblenë e Përgjithshme për të shprehur mendimin e tij dhe për të votuar në proporcion me aksionet që ai zotëron.

9.3 Aksionari nuk mund të lëshojë prokurë për të votuar për një pjesë të aksioneve të tij kur voton personalisht për pjesën tjetër të aksioneve të tij.

9.4 Asambleja e Përgjithshme mund të mbahet në një vend tjetër nga selia e regjistruar e shoqërisë, brënda Republikës së Shqipërisë apo jashtë saj.

9.5 Asambleja e Përgjithshme thirret nga Këshilli i Administrimit apo Administratori në përputhje me dispozitat e Ligjit Tregtar, apo nga një aksionar apo aksionarë të cilët përfaqësojnë të paktën 5% (pesë përqind) të kapitalit aksionar, apo nga çdo person tjetër i autorizuar sipas ligjit të zbatueshëm. Në çdo rast, Asambleja e Përgjithshme do të thirret të paktën një herë në vit, jo më vonë se muaji qershor i çdo viti me qëllim diskutimin, shqyrtimin dhe miratimin e pasqyrave financiare vjetore të vitit financiar të mëparshëm.

9.6 Rendi i ditës i Asamblesë së Përgjithshme u njoftohet aksionarëve në përputhje me këtë Statut.

9.7 Administratorët u përgjigjen me shkrim, çdo kërkese me shkrim përfshire komunikimin elektronik, për sqarim për rendin e ditës, dërguar nga aksionarët, që përfaqësojnë jo më pak se 5% të kapitalit të regjistruar të Shoqërisë, kërkesë kjo e

dërguar jo më vonë se 8 ditë përpara datës së mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme. Çdo kërkesë për sqarim, apo për informacion në kuadër të rendit të ditës së mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme duhet dërguar nga aksionarët nëpërmjet postës së regjistruar në selinë e Shoqërisë, apo nëpërmjet postës elektronike, në adresën postare elektronike të Shoqërisë, në përputhje me dispozitat e nenit 139 të Ligjit Tregëtar. Kërkesa mes të tjerave duhet të përmbajë edhe adresën e saktë të aksionarit, me qëllim kthimin e përgjigjes nga Administratorët e Shoqërisë.

9.8 Thirrja e Asamblesë së Përgjithshme u njoftohet aksionarëve, në përputhje me afatet minimale të përcaktuara në Ligjin Tregtar, nëpërmjet botimit të thirrjes dhe informacioneve në një gazetë të përditshme me shpërndarje në të gjithë vendin, në përputhje me nenin 137, pika 4 të Ligjit Tregëtar. Në këtë rast, informacionet në kuadër të rendit të ditës së mbledhjes mund te merren përgjatë afatit të botimit në selinë zyrtare të Shoqërisë, dhe këto informacione publikohen edhe në faqen zyrtare në internet të Shoqërisë, me qëllim konsultimin nga aksionarët e Shoqërisë.

9.9 Vendimet e Asamblesë mund të jenë edhe të formës qarkulluese, përsa kohë janë respektuar të gjitha kërkesat e thirrjes së saj sipas Ligjit Tregtar.

9.10 Një aksionar mund të përfaqësohet në Asamblenë e Përgjithshme, në bazë të një prokure, nga një aksionar tjetër, apo nga një person i tretë. Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të Asamblesë së Përgjithshme, e cila mund të përfshije mbledhjet vijuese, por vetëm për të njëjtin rend dite.

Neni 10 – Kuorumi dhe Kompetencat e Asamblesë së Përgjithshme

10.1 Në rastin e çështjeve, që vendosen me shumicë të zakonshme, Asambleja e Përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme, vetëm nëse janë të pranishëm ose të përfaqësuar aksionarët, që zotërojnë më shumë se 30 për qind të aksioneve, me të drejtë vote. Kur Asambleja duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar, sipas nenit 145 të Ligjit Tregtar, Asambleja e Përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme, vetëm nëse aksionarët, që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të aksioneve me të drejtë vote, apo përfaqësuesit e tyre, marrin pjesë në votim personalisht ose votojnë me shkresë apo me mjete elektronike, sipas parashikimeve të nenit 142 të Ligjit Tregtar.

Nëse Asambleja e Përgjithshme nuk mund të mblidhet për shkak të mungesës së kuorumit të sipër-përmendur Asambleja mblidhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

Vendimet e zakonshme merren me votën pro të aksionarëve, që përfaqësojnë **shumicën e thjeshtë** të aksioneve me të drejtë vote në kapitalin e Shoqërisë, që marrin pjesë në mbledhje ("**Shumica e Thjeshtë**"), sipas përcaktimeve dhe në përputhje me Nenin 145 (2) të Ligjit Tregëtar.

10.2 Asambleja e Përgjithshme merr vendime me Shumicë të Thjeshtë, sipas Nenit 10.1 me siper, lidhur me çështjet e mëposhtme:

(a) përcaktimin e politikave tregtare të përgjitshme të Shoqërisë;
(b) emërimin dhe shkarkimin e anëtarëve të Këshillit të Administrimit;
(c) emërimin dhe shkarkimin e ekspertit/ve kontabël të autorizuar dhe likuiduesve;
(d) përcaktimin e skemës së shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat (b) dhe (c);
(e) miratimin dhe zbatimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të bilancit e të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
(f) ndryshim i datës referuese kontabël apo politikave kontabël;
(g) miratimin e rregullave proceduriale të Mbledhjeve të Asamblesë së Përgjithshme;
(h) çdo çështje tjetër që përcaktohet nga ligji i zbatueshëm dhe nga ky Statut.

10.3 Në rastin e vendimeve që kërkojnë shumicë të cilësuar, këto do të merren me votën pro të aksionarëve, **që përfaqësojnë të paktën ¾ (tre të katërtat)** e aksioneve me të drejtë vote të Shoqërisë, që marrin pjesë në mbledhje ("**Shumica e Cilësuar**"), sipas parashikimeve dhe në përputhje me Nenin 145 (1) të Ligjit Tregtar.

10.4 Asambleja e Përgjithshme merr vendime me Shumicë të Cilësuar, në kuptimin e Nenit 10.3 sa më sipër, për çështjet e mëposhtme:

(a) ndryshime apo shtesa të Statutit të Shoqërisë;
(b) zmadhimi apo zvogëlimi i kapitalit të regjistruar të Shoqërisë;
(c) shpërndarja e fitimeve vjetore;
(d) riorganizimin, apo prishjen e Shoqërisë;

10.5. Asambleja e Përgjithshme merr vendime të vlefshme dhe me vendime qarkulluese që komunikohen me postë të regjistruar apo korier si edhe me Faks të cilët duhet të nënshkruhen nga aksionari (t) apo përfaqësuesit e tyre të autorizuar.

SEKSIONI III
KËSHILLI I ADMINISTRIMIT

Neni 11 – Këshilli i Administrimit

11.1 Këshilli i Administrimit përbëhet nga 3 (tre) anëtarë, të cilët emërohen nga Asambleja e Përgjithshme e Aksionarëve, me shumicë të thjeshtë votash të aksionarëve që marrin pjesë në mbledhjen e asamblesë, në përputhje me nenin 145 të Ligjit Tregtar.

11.2 Anëtarët e Këshillit të Administrimit emërohen për një afat prej 3 (tre) vjetësh dhe mund të ri-zgjidhen. Asambleja e Përgjithshme mund të shkarkojë në çdo moment Anëtarët e Këshillit të Administrimit.

11.3 Asambleja e Përgjithshme emëron Kryetarin e Këshillit të Administrimit midis anëtarëve të tij i cili ka gjithashtu të drejtën e një vote shtesë.

11.5 Administratori i Shoqërisë emërohet më shumicë të thjeshtë nga anëtarët e Këshillit të Administrimit.

Neni 12 – Mbledhjet e Këshillit të Administrimit

12.1 Këshilli i Administrimit do të mblidhet sa herë kërkohet për të mbrojtur interesat e Shoqërisë. Kryetari i Këshillit të Administrimit mund të thërrasë mbledhjen e Këshillit të Administrimit në çdo kohë, me kusht që, anëtarët e Këshillit të Administrimit të marrin njoftim të paktën 72 (shtatëdhjetë e dy) orë përpara çdo Mbledhje të Këshillit të Administrimit apo çdo anëtar të heqë dorë me shkrim nga njoftimi i mbledhjes. Kërkesa, duhet të përmbajë, rendin e ditës. Çdo mbledhje mund të mbahet me praninë personalisht të anëtarëve, apo me telekonferencë apo me mjete të ngjashme komunikimi, me kusht që, të gjithë anëtarët që marrin pjesë në mbledhje të dëgjojnë njëri-tjetrin dhe Kryetari i Këshillit të Administrimit të nënshkruajë rregullisht procesverbalin. Njoftimet për mbledhjen e Këshillit të Administrimit, dërgohen për anëtarët nëpërmjet postës elektronike (*e mail*).

12.2 Këshilli i Administrimit mund të caktojë një sekretar për mbajtjen e procesverbalit. Sekretari mund të jetë anëtar apo jo anëtar i Këshillit të Administrimit.

12.3 Mbledhjet e Këshillit të Administrimit thirren rregullisht kur janë të pranishëm shumica e anëtarëve të tij, me kusht që, në mbledhje të jetë i pranishëm Kryetari i saj.

12.4 Megjithatë, Këshilli i Administrimit merr vendime qarkulluese me shkrim, apo në forme elektronike nëpërmjet postës elektronike, pa qenë e nevojshme thirrja paraprake e saj, apo mbajtja e një mbledhje, me kusht që, ky akt të nënshkruhet në mënyrë të rregullt, nga të gjithë anëtarët e tij.

12.5 Këshilli i Administrimit merr vendime të vlefshme me votën pro të shumicës së anëtarëve të pranishëm në mbledhje.

12.6 Mbledhjet e Këshillit të Administrimit do të zhvillohen në gjuhën shqipe dhe çdo material me shkrim që do të diskutohet në këtë mbledhje do të jetë në shqip. Vendimet dhe procesverbalet e mbledhjeve do të përgatiten menjëherë pas çdo mbledhje dhe do të nënshkruhen nga Kryetari.

Neni 13 – Kompetencat e Këshillit të Administrimit

13.1 Këshilli i Administrimit ka të gjitha kompetencat lidhur me mbikqyrjen dhe kontrollin e veprimtarisë të Administratorit si edhe kryerjen e aktivitetit të zakonshëm dhe të jashtëzakonshëm të Shoqërisë nga ky i fundit, përveç atyre

kompetencave që sipas këtij Statuti, Marrëveshjes së Aksionarëve apo ligjit të zbatueshëm iu rezervohen organeve të tjera.

13.2 Përveç, detyrimeve ligjore dhe përgjegjësive sipas Ligjit Tregtar, Këshilli i Administrimit ka kompetencat dhe detyrat e mëposhtme:

(a) kontrolli dhe mbikqyrja e drejtimit të Shoqërisë, dhe miratimi dhe zbatimi i politikave tregtare të detajuara për Shoqërinë në përputhje me Aktivitetet e përcaktuara në nenin 4 të këtij Statuti, plan biznesit të Shoqërisë, nga Administratorët e Shoqërisë;
(b) me kërkesë të Asamblesë së Përgjithshme, merr masa për përgatitjen e drafteve të nevojshëm dhe draft vendimeve që janë kompetencë e Asamblesë së Përgjithshme dhe jep rekomandime;
(c) miratimi i organogramës së Shoqërisë, përgatitur nga Administratori/ët e Shoqërisë;
(d) miraton financime, kredi, over-drafte nga palë të treta, apo në favor të të treteve sipas raporteve të paraqitura nga Administratori i Shoqërisë;
(e) miraton marrëveshje me të tretë dhe/ose pagesa të caktuara, të dërguara për mendim dhe miratim nga Administratori i Shoqërisë;
(f) Miraton në bazë të sugjerimeve dhe raporteve të Administratorit të Shoqërisë konsulentët e Shoqërisë në lidhje me çështjet ligjore, ato fiskale, çështjet administrative dhe përfaqësimet në gjykata apo arbitrazhe.
(g) thërret Asamblenë e Përgjithshme sa herë e quan të nevojshme;
(h) emëron dhe shkarkon në diskrecion e saj dhe në çdo moment Administratorët e Shoqërisë dhe cakton shpërblimet e tyre.

SEKSIONI IV
ADMINISTRATORI/ËT

Neni 14 – Administratori
Kompetencat e Administratorit të Shoqërisë

14.1 Administratori (**"Administratorët e Shoqërisë"**, **"Administrator/ët"**) është person fizik, i cili mund të jetë ose jo anëtar i Këshillit të Administrimit, dhe propozohet dhe emërohet nga Këshilli i Administrimit, në përputhje me Nenin 158 të Ligjit Tregtar. Këshilli i Administrimit, apo aksionarët nëpërmjet Asamblesë së Përgjithshme, dhe me diskrecionin e tyre të plotë mund të shkarkojnë në çdo kohë Administratorin/ët për cfarëdolloj shkaku që këto e quajnë të arsyeshëm.

14.2 Administratori ka të gjitha kompetencat të kryejë veprime në lidhje me administrimin e zakonshëm të shoqërisë të cilat janë të nevojshëm për përmbushjen e objektit të Shoqërisë përveç kompetencave që u rezervohen organeve të tjera sipas këtij statuti dhe ligjit të zbatueshëm. Këto kompetenca dhe veprime janë të vlefshme dhe detyruese vetëm me nënshkrimin e Administratorit.

14.3 Administratori i Shoqërisë duhet t'i raportojë Këshillit të Administrimit në çdo kohë kur kërkohet dhe në rast të kundërt shkarkohet nga detyra nga Këshilli i Administrimit.

14.4 Në rast se Administratori ka një interes apo atë të një pale të tretë në një transaksion/veprim të caktuar të Shoqërisë, ai do të njoftojë paraprakisht me shkrim Këshillin e Administrimit dhe aksionarët ku do të specifikojnë llojin, objektin, kushtet, origjinën dhe shkallën e interesit në transaksion/ veprimin e caktuar. Administratori nuk mund të kryejë veprimin në fjalë pa autorizimin paraprak me shkrim të Këshillit të Administrimit. Administratori ka përgjegjësi përkundrejt aksionarëve të Shoqërisë për çdo veprim apo mosveprim të Shoqërisë dhe administrimin e e kryer nga këta si edhe për çdo dëm që i shkaktohet Shoqërisë si pasojë e veprimeve të tyre apo mosveprimeve të lartpërmendura.

14.5 Si rregull, Administratori përfaqëson Shoqërinë përpara të tretëve, dhe firmos në emër të Shoqërisë, përveç rasteve, të shprehura ndryshe në këtë Statut apo në Ligjin Tregëtar. Administratori është përgjegjës për hapjen apo mbylljen e llogarive bankare të Shoqërisë; ai firmos marrëveshjet dhe kontratat në emër të Shoqërisë; kryen pagesat kundrejt të tretëve, dhe përfaqëson Shoqërinë përpara institucioneve dhe enteve publike, apo atyre private; Administratori firmos në emër të Shoqërisë.

14.6 Administratori në konsultim me Këshillin e Administrimit, dhe me ndihmën e konsulentëve të Shoqërisë përgatit plan-biznesin vjetor, apo disa vjecar të Shoqërisë, dhe draftin e politikave tregëtare të Shoqërisë, në përputhje me politikat e përgjithshme tregëtare të Shoqërisë, dhe Objektit te Aktiviteteve (*Neni 4*) të Shoqërisë në këtë Statut.

14.7 Administratori përgatit organogramën dhe strukturën e punonjësve dhe/ose ofruesve të tjerë të shërbimeve të Shoqërisë, dhe ia përcjell për miratim Këshillit të Administrimit të Shoqërisë.

14.8 Përgatit raporte financiare dhe teknike, në lidhje me çështje të caktuara në veprimtarinë e përditshme tregëtare të Shoqërisë, duke përfshire por pa u kufizuar në përgatitjen e raporteve dhe informacionit në lidhje me marrëveshje, kredi, financime, over-drafte, nga ose për të tretët, dhe ia dorëzon këto për miratim Këshillit të Administrimit.

14.9 Paraqet për mendim dhe miratim Këshillit të Administrimit, marrëveshje me të tretë dhe/ose pagesa të caktuara.

14.10 Kryen regjistrimet dhe aplikimet e nevojshme për nevojat e përditshme të Shoqërisë pranë enteve dhe institucioneve publike, në përputhje me të gjatha kërkesat e ligjit Shqiptar, dhe kujdeset për afatet dhe kërkesat e tjera të ligjit në lidhje me këto regjistrime.

14.11 Raporton dhe i jep informacion Këshillit të Administrimit në lidhje me të gjitha çështjet që mund të afektojnë pozitivisht apo negativisht ecurinë e aktivitetit tregëtar të Shoqërisë.

14.12 Sugjeron dhe shtron per miratim përpara Këshillit të Administrimit konsulentët e Shoqërisë në lidhje me çështjet ligjore, ato fiskale, çështjet administrative dhe përfaqësimet në gjykata apo arbitrazhe.

14.13 Mban në mënyrë të rregullt dhe përditëson librin e aksioneve të Shoqërisë, procesverbalet dhe vendimet e mbledhjeve të Asamblesë së Aksionarëve dhe të Këshillit të Administrimit.

14.14 Mban në mënyrë të saktë dhe të rregullt dokumentat dhe librat kontabël të Shoqërisë;

14.15 Mbron interesat e Shoqërisë dhe të aksionarëve të Shoqërisë dhe zbaton në mënyrë rigoroze parimin e besnikërisë, dhe parimet më të larta të etikës.

SEKSIONI V
EKSPERTI/T KONTABËL TË AUTORIZUAR

Neni 15 – Eksperti/t Kontabël të Autorizuar

15.1 Kontrolli i brëndshëm i Shoqërisë kryhet nga një apo më shumë ekspertë kontabël të autorizuar të cilët emërohen nga Asambleja e Përgjithshme për një afat të caktuar.

SEKSIONI V
VITI FINANCIAR, FITIMET

Neni 16 – Viti Financiar

16.1 Viti financiar fillon më 1 Janar dhe mbaron më datë 31 dhjetor të çdo viti.

Neni 17 – Fitimet

17.1 Asambleja e Përgjithshme me shumicë të cilësuar në përputhje me dispozitat e Ligjit Tregtar dhe me këtë Statut, mund të vendosë në lidhje me fitimet që rezultojnë nga bilanci, pas zbritjes së rezervës ligjore dhe te gjithë shumave që Asambleja e Përgjithshme vendos si rezervë.

17.2 Asambleja e Përgjithshme mund të vendosë për krijimin e rezervave të jashtëzakonshme apo të veçanta.

SEKSIONI VI

PRISHJA – SHPËRBËRJA-BASHKIMI, LIKUIDIMI

Neni 18 – Prishja- Shpërbërja- Bashkimi

18.1 Shoqëria prishet në rastet e parashikuara në ligjin e zbatueshëm. Në rast prishje, Asambleja e Përgjithshme emëron një apo më shumë likuidues dhe u delegon këtyre kompetencat e duhura.

18.2 Gjithashtu, Shoqëria mund të shpërbëhet apo bashkohet me vendim të Asamblesë së Përgjithshme.

Neni 19 – Likuidimi

19.1 Në rast prishje, Shoqëria duhet të likuidohet.

19.2 Për administrimin e kësaj procedure, Asambleja e Përgjithshme emëron një apo më shumë likuidues, i cili do të përgatisë raportin përfundimtar lidhur me aktivin dhe pasivin e Shoqërisë si dhe për procedurat e likuidimit e kohën e nevojshme për likuidimin.

19.3 Pas përfundimit të procedurës së likuidimit, Asambleja e Përgjithshme do të marrë vendim për bilancin përfundimtar, punën e kryer nga likuiduesi/t dhe përfundimin e procedurës së likuidimit.

SEKSIONI VII
TË NDRYSHME

Neni 20 – Gjuha

20.1 Ky Statut është hartuar në gjuhën shqipe.

Neni 21 – Ligji i zbatueshëm dhe Juridiksioni

21.1 Ky Statut rregullohet nga ligji Shqiptar në fuqi dhe çdo mosmarrëveshje që lind nga dhe në lidhje me këtë Statut do të zgjidhet nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

21.3 Çdo çështje që nuk rregullohet shprehimisht në këtë Statut dhe në çdo marrëveshjen aksionarësh do të rregullohet nga Ligji Shqiptar Nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" i ndryshuar.

* * * * *

Tiranë, më 16 Shtator 2015

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTERISE TIRANE
Nr. 3428 Rep.
Nr. 2005 Kol.

V E R T E T I M

Sot me date 16.09.2015 (dymije e pesembedhjete), para meje *Mimoza I. Sadushaj*, notere ne qytetin Tirane, me studio ne Rr. " Vaso Pasha " pall. 13/1, u paraqiten personalisht :

1. **Lirim FEZOLLARI,** i biri i Feridonit, lindur me 06.04.1972, ne Pogradec dhe banues ne Tirane, madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar, identifikuar me leternjoftimin me nr. 028422343 dhe nr. Personal H20406108G.
2. **Hysen CAKA**, lindur me 08.04.1959, ne Osoje, Skrapar dhe banues ne Tirane, madhor me zotesi te plote per te vepruar, identifikuar me leternjoftimin Nr. 029301908 dhe nr. Personal F90408067D.

Te cilet nenshkruan rregullisht para meje Noteres, me vullnetin e tyre te lire dhe te plote, Statutin e shoqerise "BUKA" SHA dhe une noterja ne baze te ligjit vertetoj nenshkrimin e tyre.

N O T E R E

MIMOZA SADUSHAJ